**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**
**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/ 691
24/06/2025

## Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Belinc

E mërkurë, më 11 qershor 2025
Kohëzgjatja e takimit:17:45– 18:30
Vendi i takimit: SHF "Emin Duraku

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu,Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini, Asambleistët – Besnik Seferi si dhe Artan Lubovci

Rendi i ditës:

1. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028**

**Kyretari i Komunës z.Qemajl Aliu:** Faleminderit që sot jeni këtu në këtë dëgjim publik, të cilin e kemi thirrur për qarkoren buxhetore të vitit 2026, siç e dini ne çdo vit i marrim kërkesat nga çdo vendbanim.
Dy komponent i kemi të cilët e plotësoj, e hartojnë buxhetin, komponenta e parë janë kërkesat të cilat vijnë direkt nga qytetarët dhe e dyta janë zotimet tona. Ne këto dy komponenta i gërshetojmë dhe mundohemi çdo vit edhe t'i përgjigjemi nevojave që janë prioritare për qytetarët por edhe prioritet të cilat ne i kemi zotuar.
Buxheti i komunës është i vogël ju e dini. 2.5 milion euro i kemi investime kapitale, gjithsej i kemi 22 vendbanime, ne këtë ndarje të buxhetit e kemi bërë në mënyr të barabartë për secilin fshat, dmth në bazë të numrit të banorëve. Me këtë buxhet është problem që t'i përgjigjemi nevojave apo kërkesave dhe aq më shumë zotimeve tona. Si komunë kemi pasur fatin kësaj rradhe që përveç buxhetit lokal e kemi mbështetjen qeveritare. Qeverisa Kurti, së bashku me Ministrat e saj na ka mbështetur me çka nuk e njeh asnjëherë historia e pasluftës.
Vetëm tani që po flasim janë në proces implementi diku mbi 50 milion euro, nga enti special tek shtrati i lumit, unazat e qytetit, komuna e re, etj.
Këtu sot ne jemi për qarkoren buxhetore që t'i marrim kërkesat e juaja që më pas ato të bëhen investime. Kështu që lirisht shprehui për kërkesat të cilat i keni, për nevojat, për sygjerimet, për kritikat të cilat ju i keni.

Kërkesat e banorëve :

- **Basri Nura:** Nuk kemi trotuar dhe ndriçim në një aneksë të rrugës “Ruzhdi Salihu”. Po ashtu problem me mbeturia, tek ajo pjesë është
- **Naip Shatmani:** 100m te varrezat të rregullohet asfalti. Dy shenja të vendosen te shkolla si dhe të vendosen vija të bardha.
- **Faton Shatmani:** Rregullimi i shtratit të lumit si dhe kanalizimi. Në qendër të fshatit të bëhet një park i ngjashëm si në atë të Petrovës. Një segment i rrugës “Skënderbeu”, 100m asfaltim. (Besim Shasha). Problemi me mbeturina.
- **Sinan Krasniqi**: Rruga “Gjon Buzuku”, nuk ka ndriçim (600m).
- **Alban Hajrushi**: A është premtuar një mbi kalim për fëmijët e vegjël ?

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Belinc
Date: 11.06.2025

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | Bosri Nura | |
| 2 | FATON SHATMANI | |
| 3 | SINAN KRASNIQI | |
| 4 | ALBAN HAJRUSHI | |
| 5 | Neip Shatmani | |
| 6 | | |
| 7 | | |
| 8 | | |
| 9 | | |
| 10 | | |
| 11 | | |
| 12 | | |
| 13 | | |
| 14 | | |
| 15 | | |
| 16 | | |
| 17 | | |